



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

RELACION

“PËR MIRATIMIN E AKORDIMIT TË FONDEVE NGA EMERGJENCAT CIVILE PËR REALIZIMIN E NDËRHJRJES REHABILITUESE NË URËN MBI LUMIN GUHAK, NË QENDËR TË QYTETIT TË ÇOROVDEËS”

Të nderuar Këshilltarë!

Grupi Menaxhimit Stategjik në mbështetje, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH”, neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9936, dt.26.06.2008”, i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, Udhëzimit Nr.2, datë 24.01.2025 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2025”, Ligjit nr 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, propozon akordimin e fondeve në vlerën prej 3,000,000 leke në objektin: **Ndërhyrje Rehabilituese për rritjen e sigurisë mbi Urën në Qendër të Qytetit të Çorovodës.**

A. Përshkrimi

Ura në qendër të qytetit të Çorovodës, e cila lidh dy brigjet e lumit Guhak dhe që ka ngarkesën më të madhe të trafikut, në krahasim me dy ura të tjera që lidhin qendrën e qytetit me pjesën e sipërme të tij, paraqet disa probleme, si më poshtë:

- Shpatulla e djathtë e urës është dëmtuar nga gërryerja e lumit duke ulur sigurinë e qëndrueshmërisë së urës.
- Mbishtresat e urës janë deformuar, kanë pësuar ulje dhe deformime vertikale, duke sjellë problematikë në qarkullimin e automjeteve.
- Projekti është parashikuar që të zgjidhë këto dy problematika si dhe të realizojë përmirësimin e parrakëve të urës së bashku me ndriçimin.

B. Burimi i financimit për këtë objekt të jetë nga:

1- Fondet e Kushtëzuara të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile për vitin 2025, të cilat janë parashikuar të shpenzohen në kodin e produktit **91707AG**- Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese, të cilat janë në vlerën prej **2,558,420** lekë.

2-Fondet e planifikuara për Emergjencat Civile **artikulli 604** në buxhetin e Bashkisë për vitin 2025, në vlerën prej **441,580** lekë.

3- Fondet për Mbikqyrjen e punimeve për këtë objekt të jenë në vlerën prej 80,000 lekë

4-Fondet për Kolaudimin e punimeve për këtë objekt të jenë në vlerën prej 20,000 lekë.

Ju faleminderit

**KRYETARI
ADRIATIK MEMA**